

Z. Ardit Gabili prej muajit shkurt mban mban pozicionin e Drejtorit të Politikave kundër Krimet të Organizuar, Migracionit dhe Azilit, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ai është një profesionist me eksperiencë të konsoliduar në administratën publike, me ekspertizë në zhvillimin e kapaciteteve të administratës publike, lidhshmëri, integrimin evropian, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe menaxhimin e projekteve.

Gjatë karrierës së tij, z.Gabili ka mbajtur role të rëndësishme në institucionet qendrore në Shqipëri. Ka ushtruar detyrën e Këshilltarit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si edhe të Këshilltarit të Ministrit të Punëve të Brendshme, ku ka qenë i angazhuar në çështje të integritetit evropian, koordinimin e projekteve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe në çështje me karakter koordinues dhe menaxherial.

Më herët, ka punuar në Kryeministri, pranë Departamentit të Legjislacionit, Monitorimit të Programeve dhe Antikorrupsionit, si edhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme si këshilltar pranë zyrës së zëvendësministrit përgjegjës për integrimin evropian. Ai ka kontribuar pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) në fusha që lidhen me zhvillimin institucional, sigurimin e cilësisë dhe menaxhimin e programeve trajnuese. Krahas angazhimeve institucionale, ai ka shërbyer edhe si lektor i jashtëm pranë Albanian University, në lëndën Menaxhim Projekti.

Z. Ardit Gabili është diplomuar në Universitetin e Tiranës dhe aktualisht po ndjek studimet në fushën e European Legal Studies, ofruar nga The Ministry of Foreign and European Affairs, Defence, Development Cooperation and Foreign Trade, Luksemburg, përmes programit pasuniversitar të ofruar nga EIPA Luxembourg në partneritet me Université de Lorraine në Francë.

Ai është trajnuar dhe certifikuar në fusha si integrimi evropian, menaxhimi i projekteve, burimet njerëzore, lidhshmëri dhe trajnimi i trajnerëve, nga organizata prestigjioze ndërkombëtare në vende të ndryshme të Bashkimit Evropian, përfshirë Gjermaninë, Suedinë, Francën, Luksemburgun, si edhe pranë Parlamentit Evropian. Gjithashtu, ai është trajnuar edhe në Washington DC, SHBA.

Në nivel ndërkombëtar, z. Gabili është angazhuar si panelist, ekspert dhe pjesëmarrës në konferenca dhe forume rajonale e evropiane mbi administratën publike, menaxhimin e talenteve, cilësinë e zhvillimit profesional, performancën e shërbimit publik, menaxhimin e projekteve dhe procesin e integritetit evropian. Eksperienca e tij përfshin angazhime në Paris, Beograd, Tunis dhe Strasburg, si edhe një eksperiencë profesionale pranë Institut National du Service Public (INSP) në Paris.

Ai ka dhënë kontribut edhe në fushën e publikimeve profesionale, si drejtues i botimit “Vlerësimi i impaktit të trajnimit në Administratën Publike Shqiptare” dhe si bashkëautor i studimit “Digitalization in Training of Public Administration Personnel”, duke trajtuar çështje që lidhen me efektivitetin e trajnimit dhe rolin e dixhitalizimit në zhvillimin profesional të administratës publike në nivel rajonal.